



Planuar / Doretuar Prijemeno/Prilato Received/Delivered	12.02.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	6/4/2021		116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.02/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.02/2021 të datës 31/12/2020 të parashtruar nga ankuesi zyrtarë në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, kundër Vendimit me Nr. Prot:2547 të datës 02/12/2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetin “Haxhi Zeka” Pejë, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.02.2021, mori këtë

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.02/2021 e datës 31.12.2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet vendimi i datës 02.12.2020 me numër protokollit 2547 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin Haxhi Zeka në Pejë.
- III. Ndryshohet vendimi me nr. 1304 i datës 28.07.2020 i Komisionit Disiplinor në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit ndërsa i shqiptohet masa disiplinore: *“vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil”*
- IV. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit Haxhi Zeka të Pejës, që ankuesin nga pika 1 e këtij vendimi ta kthejë në pozitën Drejtor i Zyrës së Prokurimit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- VI. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e kryetarit të kolegjit.

Ar sy e t i m

Ndaj ankuesit punësuar në pozitën Drejtor i Prokurimit, në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, me datë 29.06.2020 është inicuar procedurë disiplinore lidhur me procedurën e prokurimit ” Ndërtimi i Fakultetit të Arteve Faza e IV”. Komisioni Disiplinor me datën 28.07.2020 ka nxjerrë Vendimin me nr. 1304 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër brenda Universitetit “Haxhi Zeka”-Pejë, në të njëjtin hap dhe gradë, dhe të njëjtit i ndalohet gradimi deri në gjashtëdhjetë (60) muaj”.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin nr. 1304 të datës 28.07.2020 të Komisionit Disiplinor në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, me datën 26.08.2017 ka parashtruar ankesë me nr.1444 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit “Haxhi Zeka “ në Pejë.

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë me datën 14.09.2020 ka përcjellë ankesën e ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me arsyetimin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit “Haxhi Zeka “ në Pejë nuk është kompetent me vendos për ankesën e z. bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-144 për Zyrtarët Publik dhe nenit 16 të Rregullores nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Me datën 16.09.2020 përmes postës ka ardhë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa me numër protokollit 1777/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 22.09.2020 ka përcjellë kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”. Me datë 09.10.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Universiteti i Pejës, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 11.11.2020 ka nxjerrë Vendimin A.nr.272/2020 me të cilin ka obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë që të bëjë shqyrtimin e ankesës me numër protokollit 1444 të datës 26.08.2020, duke shqyrtuar hollësisht të gjitha pretendimet të cilat ndërlidhen me këtë ankesë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit Haxhi Zeka në Pejë me datën 02.12.2020 nxjerrë vendimin me numër protokollit 2547 me të cilin vendim refuzon ankesën e ankuesit si të papabazuar duke lënë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 28.07.2020 me numër protokollit 1304/2020.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 02.12.2020 me numër protokollit 2547 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë, me datë 31.12.2020 përmes e-mailit zyrtar ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3369/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 16/09/2020 me numër protokollit 1777/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dosja e tenderit e përgatitur me datën 21.05.2020; Kërkesë për shtyrje të afatit dhe të hapjes së tenderit dhe afatit për sqarime në dosjen e tenderit e datës 21.05.2020; E-mail zyrtar i datës 21.05.2020; Njoftim lidhur me procesin e deri tanishëm i datës 29.06.2020; Kërkesë e datës 01.07.2020; Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave; Ankesa e datës 18.07.2020 për procedurat e konkurrimit Ndërtimi i Fakultetit të Arteve (faza e katërt); Kërkesë për sqarime shtesë 01.07.2020; Kërkesë për iniciimin

e procedurës disiplinore të datës 29.06.2020; E-mail zyrtar i datës 29.06.2020; Vendim i datës 22.06.2020 për aprovim; Vendim i datës 22.06.2020 për refuzim; Njoftim i datës 12.06.2020; E-mail i datës 21.05.2020; E-mail zyrtar i datës 22.06.2020; E-mail i datës 02.07.2020; Vendim i datës 15.05.2020; Njoftimi i datës 03.07.2020, Kërkesë e datës 01.07.2020, E-mail zyrtar i datës 01.07.2020, e-mail zyrtar për i datës 03.07.2020, Mesazh përmes e-mailit zyrtar për Driton Fetaj i datës 03.07.2020 nga anëtari i Komisionit Dokumentet për procesin e vlerësimit të tenderit me titull >Ndërtimi i Fakultetit të Arteve(Faza e katërt), e-mail zyrtar i datës 04.06.2020, e-mail zyrtar i datës 08.06.2020, Kërkesë për sqarimin shtesë për procedurën e prokurimit me titull Vlerësimi i tenderit me titull “Ndërtimi i Fakultetit të Arteve (Faza e katërt)” Nr.i Prokurimit 208 20 013 151 i datës 17.06.2020, Letër standarde e datës 12.06.2020, sqarim shtesë, Ankesat për procedurën me titull dhe nr.prokurimi Ndërtimi i Fakultetit të Arteve(Faza e katërt), uhz -20-2062-5-1-1 i datës 18.06.2020 dhe 19.06.2020; Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 03.07.2020 i intervistuari Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 03.07.2020 i intervistuari Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 03.07.2020 i intervistuari Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Vendimi me Nr.1\KD i datës 28.07.2020 i Komisionit Disiplinor të Universitetit “Haxhi Zeka , ne Pejë, Njoftimi i datës 03,07,2020, Kërkesë e datës 01.07.2020, E-mail zyrtar i datës 01.07.2020, e-mail zyrtar për i datës 03.07.2020, Mesazh përmes e-mailit zyrtar për i datës 03.07.2020 nga anëtari i Komisionit Dokumentet për procesin e vlerësimit të tenderit me titull “Ndërtimi i Fakultetit të Arteve Faza e katërt”; Ankesa e datës 18.07.2020 për procedurat e konkurrimit Ndërtimi i Fakultetit të Arteve (faza e katërt); Vendimin me Nr. Prot:1304 të datës 28/07/2020 të Komisionit Disiplinor të Universitetin “Haxhi Zeka”PejëAnkesa me nr.1444 e datës 26.08.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje në ankesë nga organi i punësisimit i datës 09.10.2020 bashkë me shkresat e lëndës; E-mail i datës 05.11.2020 nga menaxherja e personelit me provat: Vërejtje me shkrim e datës 22.06.2020 dhe Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr.496-507-510/20 i datës 28.09.2020; Ankesa e datës 31.12.2020 me numër protokollit 3369/2020 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi Nr.3/KD i datës 28.07.2020 me numër protokollit 1304 i Komisionit Disiplinor të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë; Vendimi i datës 11.11.2020 me numër protokollit 2553/2020 i nxjerrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.272/2020; Vendimi i datës 02.12.2020 me numër protokollit 2547 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë; e-mail zyrtar i datës 31.12.2020 dhe Njoftim i datës 25.11.2020 nga Menaxherja e Personelit të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 18 paragrafit 1.2 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdesë të gjitha shkresat dhe provat që na janë ofruar nga palët ka ardhë në përfundimin duke konstatuar që egziston baza ligjore që ankesa të aprovohet pjesërishtë duke ndryshuar masën disiplinore sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit se shqiptimi i masës disiplinore transfer në pozitë tjetër në të njëjtin hap dhe gradë dhe ndalim të gradimit deri në 60 muaj është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht neni 67. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e nenit 67 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 pika 1.2.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr.

04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civilë, nga dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokollit 1304 të datës 28.07.2020, nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore të cekura më lartë për faktin se nuk ka përcaktuar saktë periudhën e transferimit të ankuesit. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se në këtë rast nuk ka pas shkelje të rëndë por shkelje të lehtë bazuar në dispozitat e nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1.3 ku përcaktohet se *“vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë nxjerr Vendimin me Nr. Prot:1304 i datës 28/07/2020, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër brenda Universitetit “Haxhi Zeka”-Pejë, në të njëjtin hap dhe gradë, dhe të njëjtit i ndalohej gradimi deri në gjashtëdhjetë (60) muaj”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, poashtu pasi ka shqyrtuar dosjen e lëndës, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike që nënkupton se ankuesi gjatë zhvillimit të procedurës së tenderimit për “Ndërtimin e Fakultetit të Arteve Faza e IV” ka bërë ndonjë shkelje të rëndë sa i përket këtij procesi prokurimit, andaj edhe masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor nuk është në proporcion me shkeljen. Poashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga shkresat e bashkangjitura të lëndës nga organi i punësimit, ka konstatuar se ndaj ankuesit me datën 22.06.2020 i është dhënë vërejtje me shkrim për mosdërgimin e raporteve javore dhe se me rastin vendosjes mori në konsideratë edhe këtë dokumentë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit në përgjigjen në ankesë të datës 09.10.2020 ka cekur se Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” me datën 29.09.2020 ka pranuar vendimin nga OSHP me të cilin vendim vërtetohet shkeljet për marrjen e masave ndaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas shqyrtimit të vendimit me nr.496-507-510/20 të datës 28.09.2020, të cilin vendim Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” e ka pranuar dy muajë pas nxjerrjes së Vendimit nr.1304 të datës 28.07.2020 të Komisionit Disiplinor, ku thuhet se me këtë vendim vërtetohet arsyeja për marrjen e masave ndaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë shqyrtimit të vendimit të OSHP-së të datës 28.09.2020 ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” nuk i ka shqiptuar masën disiplinore në proporcion me shkeljet e bëra gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit “Ndërtimi i Fakultetit të Arteve Faza e IV”, sepse në Vendimin e OSHP-së të datës 28.09.2020 thuhet se: *Paneli Shqyrtues pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, vlerëson se Autoriteti Kontraktues gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve konform kërkesave të tenderit, me përjashtim të disa devijimeve të vogla. Megjithatë, Paneli Shqyrtues konsideron se Autoriteti Kontraktues në përgjithësi ka respektuar nenin 59 të LPP-së pasi që nuk ka pasur shkelje substanciale që do të ndikonin në ndryshimin e gjendjes*”, andaj Komisioni Disiplinor nuk ka vlerësuar drejtë faktet dhe provat mbi bazën e të cilave është nxjerrë Vendimi i Komisionit Disiplinor dhe se gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike nga se vendimi për masën disiplinore është marrë mbi bazë të një supozimi fiktiv pa pasur dokumentin mbi këtë rast të OSHP-së në posedim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vendimi me numër protokollit 1304 të datës 28.07.2020 i Komisionit Disiplinor në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë dhe vendimi i datës 02.12.2020 me numër protokollit 2547 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin Haxhi Zeka në Pejë janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.5 i cili përcakton se: *“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga*

pretendimet e palëve”, meqenëse Vendimi me numër protokollit 1304 të datës 28.07.2020 i Komisionit Disiplinor të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë është i paqartë dhe kundërthënës është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke marrë në shqyrtim provat që janë bashkangjitur në këtë lëndë nga palët në procedurë si dhe duke pasur në konsideratë edhe rrethanat e tjera që lidhen me performancën profesionale dhe etike të ankuesit duke përfshi edhe shqiptimin e vërejtjes me shkrim në të kaluarën, konstaton se nuk ka pasur bazë ligjore për shqiptimin e masës disiplinore “largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër brenda Universitetit “Haxhi Zeka”-Pejë, në të njëjtin hap dhe gradë, dhe të njëjtit i ndalohet gradimi deri në gjashtëdhjetë (60) muaj”, por se janë konsumuar të gjitha elementet konformë dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1.3. dhe që ndaj ankuesit të shqiptohet masa disiplinore “vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil”.

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit Haxhi Zeka të Pejës është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës në pozitën Drejtor të Zyrës së Prokurimit si dhe të vendos në dosje personale masën disiplinore “vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil” e shqiptuar sipas këtij vendimit.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: “Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: “Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.02/2021, datë 12.02.2021

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Procesëmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- *Ankuesit*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

